



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç) pika 1.7 paragrafi (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke u mbështetur në nenin 4 pika 3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.
Duke pasur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikat e veprimit për zhvillimin e resurseve njerëzore nga fusha e mirëqenies sociale.

Me qëllim të rregullimit dhe avancimit të punës profesionale, hulumtuese e këshillëdhënëse të Institutit për Politikë Sociale, për sigurim cilësor dhe efikas të shërbimeve sociale dhe familjare, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2006
PËR
THEMELIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË
DEPARTAMENTIT TË INSTITUTIT PËR POLITIK SOCIALE**

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim vendosjen dhe përcaktimin e rregullave dhe procedurave për themelimin dhe fushëveprimin e Këshillit Drejtues të Institutit për Politik Sociale (në tekstin vijues Këshilli i IPS), përmes të cilit do të bëhet drejtimi dhe monitorimi i aktiviteteve hulumtuese e këshillëdhënëse të Institutit për Politikë Sociale për shërbime profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Neni 2

Këshilli i DIPS

Këshilli si një mekanizëm i krijuar me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare është përgjegjës, që ta ndihmojë profesionalisht punën hulumtuese e këshilluese profesionale të Institutit për Politikë Sociale dhe institucioneve, të cilat ofrojnë shërbime sociale sipas standardeve ndërkombëtare dhe ligjeve të aplikueshme në vendin tonë.

Neni 3

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit DIPS

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Drejtues të Institutit të Politikës Sociale konsistojnë në:

- Ofrimin dhe sigurimin e ndihmës profesionale nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare për Institutin e Politikës Sociale,
- Shqyrtimin dhe dhënien e pëlqimit për të gjitha dokumentet hulumtuese dhe studimore të përgatitura nga Institutit i Politikës Sociale,
- Ofrimin e ndihmës profesionale për shfrytëzimin e mjeteve financiare, lidhur me realizimin e projekteve hulumtuese dhe studimore të IPS-së,
- Propozimin e çështjeve të rëndësishme për hulumtime në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare,
- Shqyrtimin e akteve nënligjore të cilat zhvillojnë dhe avancojnë fushëveprimin e IPS,
- Ofrimin e këshillave në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për Drejtorin dhe punëtorët tjerë të Institutit,
- Përcaktimin e standardeve profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare,
- Ofrimin e ndihmës në përcaktimin e prioriteteve financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara në Ligjin për Shërbime sociale dhe familjare,
- Shqyrtimin dhe dhënien e pëlqimit për Planin vjetor të punës së Institutit për Politikë Sociale,
- Shqyrtimin dhe aprovimin e propozimeve dhe rekomandimeve të ndryshme të Drejtorit të Institutit që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Institutit si dhe detyra dhe kompetenca tjera nga fushëveprimi i tij.

Neni 4

Themelimi i Këshillit të DIPS

(1) Në mandatin e parë i cili zgjatë 3 vjet, anëtarët e Këshillit i emëron Ministri i MPMS-së. Të njëjtit kanë të drejtë rizgjedhje. Po ashtu, Ministri ka të drejtë ta emërojë edhe Kryetarin e Këshillit i cili e drejton atë gjatë mandatit të parë.

Përzgjedhja bëhet nga komisioni prej pesë anëtarësh, të cilin e formon kabineti i ministrit të MPMS-së.

(2) Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe rregullat e këtij Udhëzimi Administrativ, Ministri i MPMS-së e autorizon Departamentin e Institutit të Politikës Sociale që në emër të MPMS-së, të marrë iniciativë për themelimin e Këshillit.

(3) Të gjitha punët paraprake teknike, administrative dhe profesionale përkitazi me themelimin dhe funksionalizimin e Këshillit do ti kryejë Departamenti i Institutit të Politikës Sociale i MPMS-së.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit

Kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit janë:

1. Dëshmia se ka përvojë pune në fusha të ngjashme me shërbimet sociale dhe familjare, së paku tri vite,
2. Publikime të ndryshme në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare,
3. Të ketë respekt shoqëror, moral dhe besueshmëri,
4. Të jetë i diplomuar në këto drejtime: Punë Sociale, Psikologji, Sociologji, Drejtësi dhe Pedagogji.
5. Përparësi ka kandidati i cili posedon titull shkencor në fushat e përmendura.

Neni 6

Përbërja numerike dhe përfshirja institucionale në Këshill

(1) Këshilli do ti ketë 7 anëtarë, të cilët për tri vitet e para i emëron ministri, duke u kujdesur që përbërja e këshillit të përfshijë spektër të gjerë të profesionistëve dhe përfaqësimit të këtyre subjekte:

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 1 anëtar;
2. Asociacioni i komunave të Kosovës 1 anëtar,
3. Universitetit i Prishtinës 1 anëtar
4. Organizatat jo qeveritare 1 anëtar
5. Komisioni Parlamentar për shëndetësi dhe mirëqenie sociale 1 anëtar,
6. Shfrytëzuesit e shërbimeve sociale 1 anëtar, dhe
7. Drejtori i Institutit për Politikë Sociale ,

(2) Pas tri viteve të para të punës së tij, Këshilli do të ketë mundësinë e organizimit të vet, dhe nga radhët e veta do të zgjedhë Kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit.

Neni 7

Funksionimi i Këshillit

- (1) Anëtarët e Këshillit nuk mund të kenë pozitë e cila nuk është në pajtim me funksionet e tyre në Këshill.
- (2) Anëtarët e Këshillit gjatë aktivitetit të tyre në Këshill, duhet të jenë të pavarur e të paanshëm, të mos ndikohen nga asnjë grup i interesit në ushtrimin e funksionit të tyre.
- (3) Për funksionimin e drejtë dhe efikas të Këshillit përkujdeset dhe angazhohet Drejtori i Departamentit të Institutit të Politikës Sociale.
- (4) Këshilli punën e vet e zhvillon në mbledhje apo në forma të tjera, të cilat mund të përcaktohen në Rregulloren e punës së Këshillit.

Neni 8

Rregullat e punës së Këshillit

Këshilli për punën e vet dhe çështje e tjera nga kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara mund të nxjerr Rregullore pune dhe akte tjera nënligjore, të cilat nuk mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 9

Mandati i anëtarëve të Këshillit

- (1) Mandati i ushtrimit të punëve dhe detyrave të anëtarëve të Këshillit është 3 vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për 3 vite tjera. Asnjë anëtar i Këshillit nuk mund ta kryejë këtë funksion më shumë se 6 vjet, përkatësisht dy mandate.
- (2) MPMS-ja apo vet Këshilli mund ti referojnë Gjykatës Supreme në rast se një anëtar i Këshillit ka dështuar në kryerjen e punëve të përcaktuara me rregullat e Këshillit, ndërsa pas shqyrtimit të dëshmive mund të marrë masa ndaj anëtarit që ka shkel rregullat duke e përjashtuar nga Këshilli.
- (3) Në rast të ndërprerjes së punës së një anëtari të Këshillit, Ministri i MPMS-së emëron një anëtar të ri, i cili i kryen punët dhe detyrat e tij deri në përfundim të mandatit të mbetur.

Neni 10

Institucionet përgjegjëse për krijimin e kushteve të punës së Këshillit

- (1) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht Departamenti i Institutit të Politikës Sociale i siguron kushtet e punës, në mënyrë që Këshilli të mund ta kryej me sukses punën e vet.
- (2) Për angazhimin e tyre në Këshill, anëtarët do të paguhen në formë honorari, të cilin me kërkesën e MPMS-së do ta përcaktojë Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
- (3) Financimi i punës së Këshillit do të bëhet nga mjetet e buxhetit të MPMS-së.

Neni 11

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të aplikohet nga dita e themelimit të Këshillit.

Prishtinë, prill 2006

**Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj**
